



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

K.Dh.SH.II.nr.1324/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kosovo Menagmente Institute OP me numër identifikues 810902206 me seli në Prishtinë, kundër debitorit Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Instituti Pedagogjik i Kosovës, me seli në Prishtinë, lidhur me pagesën e borxhit, në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1895/22 të datës 29.06.2023, jashtë seancës gjyqësore, me datë 24.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e debitorit Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Instituti Pedagogjik i Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1895/22 i datës 29.06.2023, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1895/22 të datës 29.06.2023, ka vendosur si në vijim: I. Refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Instituti Pedagogjik i Kosovës, me seli në Prishtinë, i ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr.20/22 i datës 03.02.2022 të lejuar nga Përmbaruesi privat Irfan I.Kërçagu, II. Mbetet në fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.20/22 i datës 03.02.2022 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Irfan I.Kërçagu.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë përfaqësuesja e debitorit, për

shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatim të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovet ankesa si e bazuar dhe te priset aktvendimi KPPP.nr.1895/22 dt.29.06.2023, si të kundërligjshëm.

Gjyqtari individual i Dhomës së dytë të Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Përmbare si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pa themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori: Kosovo Menagmente Institute OP me numër identifikues 810902206 me seli në Prishtinë, me dt.03.02.2022, ka paraqitur propozim për përmbare ndaj debitorit Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Instituti Pedagogjik i Kosovës, me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm, faturës nr.2021/005 të datës 13.12.2021, për shumën në vlerë prej 3,400.00€.

Përmbareuesi Privat Irfan I.Kërçagu, duke vepruar sipas propozimit për përmbare të kreditorit, me Urdhrin P.nr.20/22 të dt.03.02.2022, ka lejuar përmbaremin, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm - fatura nr.2021/005 të datës 13.12.2021, i plotëson kushtet për përmbare.

Ndaj këtij urdhri, debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbaremor, me arsyetimin se nuk ka asnjë detyrim të pretenduar nga kreditori. Fatura në bazë të së cilës është iniciuar procedura përmbaremore nuk është e përshtatshme për përmbare ngase e njëjta nuk është pranuar në mënyrë të rregullt në kuptim të nenit 27 të LPP-së, i propozon gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, të anulohet urdhri përmbaremor

Kreditori në përgjigjen në prapësim deklaroi se pas pranimit të konfirmimit zyrtar për pjesëmarrje ne trajnim te katër zyrtarëve te debitorit, ka bërë rezervimin e biletave kthyses me qëllim të organizimit dhe mbajtjes së trajnimit për zyrtaret e debitorit. Në këtë drejtim, debitorit ia ka dërguar kontratën dhe faturën të cilën debitori e ka pranuar dhe e ka nënshkruar, ndërsa arsyetimi i debitorit për mospjesëmarrje ne trajnim është i pasakte, ngase kreditori ka bërë të gjitha aranzhimet teknike dhe shpenzime për realizimin e shërbimeve te porositura nga debitori, i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar, ndërsa urdhri përmbaremor të mbetet në fuqi.

Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin të debitorit, dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1895/22 të datës 29.06.2023, ka Refuzuar prapësimin e debitorit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të të njëjtit.

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar ndër të tjera ka theksuar se fatura nr.2021/005 dt.13.12.2021 mbi bazën e se cilës është lejuar urdhri për përmbare, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të

LPP-së, kjo pasi që në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara qartë shërbimet të cilat i janë ofruar debitorit, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Gjykata vlerësoj pretendimet tjera të debitorit të ngritura në prapësim por gjeti se nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit është vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të dhomës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, të LPK-së, apo procedurës përmbarimore, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet për mosplotësimin e kushteve për lejimin e përmbarimit dhe as pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata në procedurë përmbarimore e vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit të besueshëm, vlerëson nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit përmbarimor dhe a ekzistojnë ndonjëra nga shkaqet për prapësim nga neni 71 i LPP-së.

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret, përmbarimi i lejuar me anë të dokumentit të besueshëm - faturës nr.2021/005 dt.13.12.2021, në të cilën është mbështetur dhoma e shkallës së parë, e që vlerësohet si e drejt nga kjo gjykatë, mbështetet në dispozitat ligjore nga neni 29 paragrafi.1 pika 1.3 dhe paragrafi. 3 të LPP-së me të cilin theksohet se: *“1. Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.3. faturat; ndërsa paragrafi. 3. Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.* Nga dispozita e lartcekur shihet çartë se dokumenti me të cilin kreditori e ka kërkuar përmbarimin është i besueshëm, në të është treguar kreditori dhe debitori, shuma e cila duhet të paguhet, e njëjta është pranuar nga ana e debitorit.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se dhoma e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat e LPP-së, kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate sipas shkresave të lëndës konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës nr.20/22 të datës 03.02.2022, i cili në mbështetje të dispozitave nga nenin 29 paragrafi 1 pika 1.3 dhe par 3 të LPP-së, e ka cilësinë e dokumentit të besueshëm.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, nuk i vlerësoi si të bazuara pretendimet ankimore se fatura nuk paraqet detyrim për debitorin sepse shërbimi nuk është pranuar, kjo gjykatë vlerësoi se fatura përmbarimore bashkangjitur propozimit për përmbarim të kreditorit, i plotëson kushtet ligjore për tu konsideruar si dokument i besueshëm nga neni 37 të LPP-se, sepse debitori e ka pranuar faturën e kreditorit, që nënkupton se ka pranuar

detyrimin për shërbimin e ofruar nga kreditori.

Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K..Dh.Sh.II.nr.1324/23 me datë 24.04.2024

Gjyqtari

Krenar Berisha